

2024

# PLANI I INTEGRITETIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

# **PLANI I INTEGRITETIT**

## **MINISTËR I SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN**

**2024–2025**

## **Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit për Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin**

- |                       |                  |
|-----------------------|------------------|
| 1. Znj. Fotjona Taçe  | Drejtor Kabineti |
| 2. Znj. Silvana Rusi  | Këshilltar       |
| 3. Z. Loren Koçollari | Këshilltar       |

# PËRMBAJTJA

<b>DEKLARATA E INTEGRITETIT.....</b>	<b>4</b>
<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>5</b>
<b>1. PLANI I INTEGRITETIT.....</b>	<b>6</b>
1.1. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit.....	6
1.1.1 Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit.....	6
1.1.2 Identifikimi dhe Analiza e Riskut.....	6
1.1.3 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut.....	7
<b>2. QASJA METODOLOGJIKE.....</b>	<b>7</b>
<b>3. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT.....</b>	<b>8</b>
<b>4. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT TË IDENTIFIKUARA.....</b>	<b>8</b>
4.1 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me kuadrin e brendshëm rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën.....	8
4.2 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimin e tyre fillestar dhe vazhdues për çështje të integritetit.....	9
4.3 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me transparencën dhe komunikimin me publikun dhe aktorët e jashtëm mbi veprimtarinë e MAPA.....	9
<b>5. PLANI I VEPRIMIT DHE MONITORIMIT.....</b>	<b>10</b>

## DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Lufta kundër korrupsionit është ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Përmes zbatimit konsistent të kësaj agjende prioritare, synohet të vendosen themele solide për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe mirëqeverisjes me institucione publike që veprojnë me integritet, transparencë dhe llogaridhënie.

Plotësimi i kabinetit qeveritar prej janarit 2024 me pozicionin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, konsiderohet një dëshmi e vëmendjes së shtuar ndaj prioriteteve ndërmarra në drejtim të luftës kundër korrupsionit për të sinergjizuar në mënyrë solide parandalimin e incidencës së korrupsionit dhe garantuar integritet të institucioneve publike. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin koordinon dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave kombëtare, si dhe hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për parandalimin dhe luftën gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit për avancimin në ndërtimin e një administrate të standardeve evropiane që funksionon mbi baza integriteti, etike dhe meritokracie.

Miratimi i këtij Plani Integriteti dhe Planit të tij të Veprimit 2024-2025 është hapi i radhës në këtë drejtim nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Përmes miratimit të Planit të Integritetit, Ministri i Shtetit synon rritjen e performancës institucionale përmes ndikimit të drejtpërdrejtë në ushtrimin me integritet dhe profesionalizëm të funksioneve dhe detyrave shtetërore të zyrtarëve të institucionit. Hapat e diktuar në brendi të këtij instrumenti strategjik normojnë identifikimin dhe parandalimin e risqeve ndaj korrupsionit që cenojnë integritetin e zyrtarëve gjatë ushtrimit të detyrës sipas fushës institucionale të përgjegjësisë, si dhe parashikojnë masa konkrete për adresimin e tyre.

Mbetemi besimplotë se ky instrument konsolidon më tej vullnetin tonë për integritet institucional dhe furnizon me një busull etike proceset e brendshme vendimmarrëse dhe operacionale mbështetur në parimet e mirëqeverisjes dhe profesionalizmit, për të cilat Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit udhëheq përmes shembullit.

**Adea Pirdeni**

**Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin**

## LISTA E SHKURTESAVE

MAPA	Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BNJ	Burime Njerëzore
DAP	Departamenti i Administratës Publike
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit
PI	Plani i Integritetit
PT	Programi i Transparencës
PSV	Procedura Standarde Veprimi
PV	Plani i Veprimit

## 1. PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) u hartua gjatë periudhës Maj – Gusht 2024, në mbështetje të dokumentit të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore. Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- i. Vlerësimi i risqeve të integritetit, me të cilat mund të përballen funksionarët e kabinetit të MAPA-s gjatë ushtrimit të detyrave të tyre me paanshmëri dhe përgjegjshmëri; si dhe
- ii. Përcaktimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe shkakut të tyre u referohet proceseve të punës sipas fushës së përgjegjësive të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, të cilat përfshijnë:

- i. Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave, për menaxhimin dhe energjizimin e burimeve njerëzore të administratës publike, ndërtimin e institucioneve të administratës shtetërore, dhe trajnimin e të punësuarve të administratës publike;
- ii. Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit;
- iii. Koordinimin ndërinstytucional për përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë dhe partneritetit për qeverisje të hapur.

### 1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit dhe miratimit të Planit të Integritetit nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

#### 1.1.1 Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit

Me Urdhër nr. 5, datë 03.05.2024, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ngrii Grupin e Punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e Planit të Integritetit të MAPA-s, të përbërë nga 3 anëtarë (zyrtarë të Kabinetit të Ministrit), me qëllim hartimin e Planit të Integritetit dhe masave të përshtatshme kontrolluese dhe korigjuese për personat me funksione të larta ekzekutive në MAPA.

#### 1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, analiza e Grupit të Punës u fokusua në identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe shkaqeve të tyre, përmes analizimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për fushën e përgjegjësive së MAPA-s, veprimtarinë, kompetencat dhe detyrat e institucioneve që mund të lidhen me të.

Në vijim, Grupi i Punës u fokusua në analizën dhe vlerësimin e risqeve dhe faktorët që ndikojnë në rritjen e intensitetit të tyre. Në analizë u morën detyrat dhe kompetencat e MAPA-s dhe detyrat e anëtarëve të kabinetit, duke kryer një vlerësim të fushave të cilat rezultojnë më të ekzpozuar ndaj risqeve të integritetit. Në bazë të rezultateve të kësaj analize risqet e identifikuara u renditën sipas rëndësisë dhe ndikimit të tyre të mundshëm.

### **1.1.3 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut**

Me qëllim adresimin e risqeve të integritetit të identifikuar, grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin tyre. Plani i veprimit përfshin masa të përshtatshme kontrolluese dhe korrigjuese, të cilat synojnë ushtrimin me integritet të detyrës nga zyrtarët e lartë politik të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Plani i veprimit përmban parashikimin e masave dhe aktiviteteve përkatëse, institucionet përgjegjëse dhe objektivat për dy vite.

Konkretisht, zbatimi i këtij Plani Integriteti dhe Planit të tij të Veprimit është parashikuar për periudhën 2024 - 2025.

## **2. QASJA METODOLOGJIKE**

Plani i Integritetit dhe Plani i tij i Veprimit është hartuar në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 334, datë 07.10.2020 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore” dhe është bazuar në praktikat më të mira rreth çështjeve të integritetit në institucionet shtetërore.

Me Urdhrin nr. 5, datë 03.05.2024 Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ngriti grupin e punës për hartimin e planit të integritetit dhe masave të përshtatshme kontrolluese dhe korrigjuese për anëtarët e kabinetit pranë tij.

Grupi i punës ka zbatuar një kalendar intensiv mbledhjesh dhe takimesh, përgjatë periudhës së hartimit, për të siguruar hartimin e një Plani të Integritetit dhe Planit të tij të Veprimit që reflekton dhe i përgjigjet efektivisht situatës dhe nevojave aktuale institucionale.

Fokusi i punës së grupit të punës ka qenë i shtrirë në këto drejtime kryesore:

1. Analizë e kuadrit ligjor dhe institucional të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
2. Analizë e proceseve të punës sipas fushës së përgjegjësisë së institucionit;
3. Analizë mbi aspektet e transparencës dhe komunikimit të institucionit;
4. Analizë mbi menaxhimin e burimeve njerëzore.

Rezultatet e analizës së kryer u integruan në Planin e Integritetit dhe shërbyen si baza për hartimin e Planit të Veprimit dhe masave përkatëse, të cilat i referohen stafit të kabinetit të MAPA-s.

Risqet e identifikuar u ndanë në fushat e mëposhtme:

1. Kuadri rregullator dhe institucional;
2. Menaxhimi i burimeve njerëzore;
3. Transparenca dhe komunikimi me aktorët e jashtëm.

Mbi bazë të informacionit të sipërcituar, grupi i punës vijoi me hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Planit të Veprimit 2024-2025 në zbatim të tij, ku u përcaktuan konkretisht masat dhe aktivitetet e



nevojshme, që pritet të kenë impakt pozitiv në kuadër të integritetit institucional, afatet për zbatimin e tyre dhe indikatorët përkatës.

### 3. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet si më poshtë:

- **Deklarata e Integritetit Institucional** – shprehja e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- **Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të MAPA** – përshkrimi i fazave të procesit të planifikimit të integritetit dhe qasja metodologjike;
- **Risqet e integritetit dhe faktorët e tyre** – përshkrimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre sipas fushës së përgjegjësisë së MAPA-s;
- **Plani i Veprimit** – masat e kontrollit që duhet të ndërmerren për të adresuar risqet e identifikuara.

### 4. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT TË IDENTIFIKUARA

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza e risqeve të integritetit dhe faktorët e tyre, klasifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së MAPA-s dhe veprimtarisë si më poshtë:

#### 4.1 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me kuadrin e brendshëm rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën

Në lidhje me kuadrin rregullator dhe institucional, vërehet mungesa e Kodit të Etikës për anëtarët e kabinetit politikë të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Në këto kushte, nevojitet miratimi i një Kodi Etik, i cili duhet të parashikojë rregulla që normojnë dhe disiplinonjë sjelljen e tyre. Ky Kod, duhet të përmbajë parashikime që lidhen me: procesin e deklaramit dhe pranimit të dhuratave, administrimit të regjistrit përkatës apo përfitime të tjera të ngjashme, shpenzimet e mbuluara nga të tjerët; rregullat për pranimin e donacioneve/sponsorizimeve dhe funksionimin e regjistrit përkatës; rregullat për deklarimin nga ana e tyre të takimeve me lobistë apo grupe interesi; rregullat për veprimtaritë e jashtme të tyre si dhe detyrimin e standardet e sjelljes së pas mbarimit të detyrës (pas-punësimi).

Për rrjedhojë, hartimi dhe miratimi i një Kodi Etike do të ishte domosdoshmëri dhe nevojë për mbarëvajtjen e punës së kësaj strukture. Pas konkludimit të këtij dokumenti, duhet të sigurohet shpërndarja e Kodit Etik tek funksionarët e kabinetit dhe trajnimi i tyre, me qëllim implementimin efektiv të detyrimeve që burojnë prej tij.

Sa më sipër, deri në momentin e miratimit të Kodit Etik të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, funksionarët e kabinetit politikë të MAPA-s duhet të zbatojnë Kodin e Etik të Kryeministrit.

## **4.2 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimin e tyre fillestar dhe vazhdues për çështje të integritetit**

Promovimi i zbatimit efektiv të standardeve për sjelljen etike të zyrtarëve të lartë politik në sektorin publik është një parakusht esencial për garantimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe besimit të qytetarëve. Për të kontribuar në ndërtimin e një kulture të fortë integriteti është i nevojshëm ndërgjegjësimi dhe përmirësimi i njohurive të këshilltarëve politikë të kabinetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, për zbatimin praktik të kërkesave ligjore ekzistuese në fushën e etikës, parandalimit të konfliktit të interesit dhe integritetit.

Për këtë qëllim, anëtarët e kabinetit do të kryejnë një trajnim fillestar sapo të jenë emëruar në detyrë për çështje që lidhen me integritetin dhe antikorrupsionin, duke përfshirë Kodin Etik Ministror, legjislacionin dhe të gjithë kuadrin rregullator kundër korrupsionit dhe integritetit.

Njëkohësisht, me qëllim ndërgjegjësimin sistematik do të zhvillohen trajnime periodike dhe të vazhdueshme për etikën dhe antikorrupsionin për anëtarët e kabinetit pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (plan periodik i miratuar).

## **4.3 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhur me transparencën dhe komunikimin me publikun dhe aktorët e jashtëm mbi veprimtarinë e MAPA-s.**

Nisur nga analiza e elementëve të transparencës dhe komunikimit, konstatohet mungesa e një faqe zyrtare të internetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Për këtë qëllim, duhet të merren masa për të krijuar kushtet e nevojshme digjitale tu pajisur me një web faqe zyrtare. Faqja zyrtare e MAPA-s duhet të përmbajë të gjithë elementët që garantojnë një transparencë maksimale, duke mundësuar publikime të rregullta permanente dhe ato mbi baza mujore/e-buletinet. Më shumë rëndësi vlerësohet pasurimi i faqes zyrtare të internetit, me informacione mbi pikat e kontaktit të ndryshme, në mënyrë që të kemi një komunikim efikas dhe të gjerë me publikun dhe ofrimin e kanaleve të komunikimit.

Nga ana tjetër vlerësohet e rëndësishme publikimi i informacionit mbi këshilltarët politikë, profilizimit dhe veprimtarisë së tyre në faqen zyrtare të internetit të MAPA-s, si dhe të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe atë të Konsultimit Publik, duke përfshirë kontaktin e koordinatorit dhe publikime mbi proceset e konsultimit të realizuara. Referuar fushës së përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe veprimtarisë institucionale të tij, MAPA duhet të garantojë mekanizmat e nevojshëm me qëllim që procesi i konsultimit publik (për ato akte ligjore e nënligjore të inicjuara prej saj) të jetë i aksesueshëm për të gjithë qytetarët dhe palët e interesit, duke garantuar kështu efektivitet dhe gjithëpërfshirje në politikbërje në fushën e administratës publike dhe antikorrupsionit.

## 5. PLANI I VEPRIMIT DHE MONITORIMI

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për trajtimin dhe adresimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të identifikuar sipas fushës së përgjegjësisë së MAPA-s dhe proceseve të punës më të ekspozuara. Ky dokument përbën një mekanizëm efektiv për menaxhimin dhe kontrollin e riskut, duke synuar eliminimin e tij, parashikimit të masave dhe aktiviteteve, përcaktimit të afateve për realizimin e tyre dhe zbatimit rigoroz nga strukturat përgjegjëse. Plani i Veprimit ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

- **Objektivi 1.** Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Kodit të Etikës;
- **Objektivi 2.** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rishikimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese, me qëllim aftësimin profesional të zyrtarëve;
- **Objektivi 3.** Rritja e transparencës dhe komunikimi me publikun dhe aktorët e jashtëm të lidhur me veprimtarinë e MAPA-s.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit, masave dhe aktiviteteve të parashikuara në të do të kryhet kryhet sistematikisht, me periodicitet 6 mujor dhe vjetor dhe përfshin verifikimin e zbatimit të detyrave të ngarkuara, brenda afateve të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse, për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të miratuara në planin e veprimit. Pjesë e monitorimit do të jetë vlerësimi i efektivitetit të masave të zbatuara, impaktit pozitiv që kanë sjellë ato në uljen e risqeve të integritetit dhe eliminimin e faktorëve të tyre, me qëllim vlerësimin e rishikimit të masave ekzistuese dhe parashikimin e masave të reja në të ardhmen. Çdo 6 muaj do të përgatitet raporti përkatës i monitorimit, të planit të integritetit të MAPA-s dhe do të përcaktohen personat përgjegjës për koordinimin e këtij procesi.

**Objektivi 1. Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Kodit të Etikës**

Fusha me risk/ faktorët e riskut	Masa për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e integritetit	Prioritarizimi i masës	Struktura përgjegjëse	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Afati i zbatimit të aktivitetit	Indikatori matës
Risqet dhe faktorët me risk që lidhen me kuadrin e brendshëm rregullator dhe institucional mbi etikën dhe integritetin	Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional mbi etikën dhe integritetin	I Lartë	MAPA	1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Kodit Etik	6M1 2025	Kodi Etik i miratuar me urdhër të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe i shpërndarë për njohje
				1.2 Kryerja e analizës dhe përcaktimi i vlerave dhe standardeve	6M1 2025	
				1.3 Miratimi dhe publikimi i Kodit Etik, ku mes të tjerash, të përcaktohen: - rregullat për pranimin e dhuratave; - shpenzime të mbuluara nga të tjerët; - rregulla për pranimin e donacioneve/sponsorizimeve; - rregulla për deklarimin e tyre me lobistë; - rregulla për veprimtarinë e tyre të jashtme; - rregulla për standardet e sjelljes paspunësimit.	6M2 2025	
				1.4 Trajnimi i kabinetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin lidhur me përmbajtjen e Kodit Etik	6M2 2025	

**Objektivi 2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rishikimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese**

Fusha me risk/ faktorët e riskut	Masa për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e integritetit	Prioritarizimi i masës	Struktura përgjegjëse	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Afati i zbatimit të aktivitetit	Indikatori matës
Risqet dhe faktorët me risk që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kualifikimin e tyre	Rishikimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese për ruajtjen e integritetit të funksionarëve politik	I Lartë	MAPA	1.1 Trajnim fillestar për anëtarët e kabinetit për integritetin dhe antikorrupsionin	2024-2025	Trajnime të zhvilluara për çështje të etikës dhe integritetit
				1.2 Trajnime periodike për etikën dhe antikorrupsionin për anëtarët e kabinetit pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (plan periodik i miratuar).	2024-2025	
				1.3 Trajnim mbi procedurat, mjetet për raportimin, ndjekjen dhe zgjidhjen e çështjeve të etikës dhe integritetit.	2024-2025	

Objektivi 3. Rritja e transparencës dhe komunikimi i publikut me aktorët e jashtëm të lidhur me veprimtarinë e MAPA-s

Fusha me risk/faktorët e riskut	Masa për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e integritetit	Prioritarizimi i masës	Struktura përgjegjëse	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Afati i zbatimit të aktivitetit	Indikatori matës
Risqet dhe faktorët me risk që lidhen me rritjen e transparencës dhe komunikimin me publikun dhe aktorët e jashtëm	Rritje e transparencës dhe përmirësimi i planit të komunikimit dhe visibilitetit për aktivitetin e MAPA-s	I Lartë	MAPA	1.1 Krijimi i kushteve digjitale/inxhenerike për krijimin e faqes zyrtare të Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin	6M2 2024	Faqja zyrtare e MAPA e krijuar dhe e përditësuar me informacion të plotë, në përputhje me Programin e Transparencës
				1.2 Publikimi i informacionit të zgjeruar mbi anëtarët e Kabinetit, profilin, veprimtarinë dhe fushën e përgjegjësisë që ata ndjekin	6M2 2024	
				1.3 Publikime mbi proceset dhe veprimtaritë e kryera, si dhe i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në kuadër të transparencës me publikun	6M2 2024	
				1.4 Publikimi i Vendimeve të Këshillit të Ministarve që lidhen me fushën e kompetencës së MAPA-s	6M2 2024	
				1.5 Publikimi i të dhënave për të drejtën e informimit dhe koordinatorin e informimit	6M2 2024	
				1.6 Publikimi i të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik dhe i akteve për konsultim publik	6M2 2024	